



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V\_345\_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_470\_10\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_470\_10\_10**;
6. Apelimi i KEK-ut me datë 14.03.2011;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Gafurr Halili (shifra e konsumatorit DFE – 945) nga Ferizaj, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 24.03.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 23.02.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 26.12.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 8183206 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 4692437.  
**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 008498 datë 26.12.2008
- Me datë 16.04.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 8183206, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllobat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme njehsori e ka qelqin e ndërruar, tabelën e gërvishur si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 32/16 i datës 16.04.2009
- Me datë 12.05.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë të konsumatorit dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 347149 i datës 12.05.2009
- Me datë 19.05.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE09HP04375 në vlerë prej 2,217.87 €. **Provë:** Fatura DFE09HP04375 e datës 19.05.2009



- Me datë 26.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 23.02.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 23.02.2010
- Me datë 24.03.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 07.10.2010 DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_470\_10\_10 dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka vendosur që të aprovojë ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfundim se:
  1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura e rikthimit të humbjeve DFE09HP04375 e datës 19.05.2009 në vlerë prej 2,217.87 €.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_470\_10\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: ZRRE/DMK\_V\_470\_10\_10 të mbetet në fuqi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar